



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2018:057677

Datë: 24.10.2018

Numri i dokumentit: 00159041

VENDIM ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
SI DOKUMENTI I PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC



13. 02 - 2019

P.nr.872/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjyquese Hakile Ilazi, me praktikanten e kësaj gjykate Marigona Shaqiri, në çështjen penale kundër të akuzuarve [REDACTED], për shkak se ne vazhdimësi dhe ne bashkëkryerje ka kryer veprën penale Vjedhje e rende nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-së, kundër te akuzuarit [REDACTED] për shkak se ne bashkëkryerje me te akuzuarin e pare [REDACTED] kane kryer veprën penale Vjedhje e rende nga neni 327 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, kundër te akuzuarve [REDACTED] te akuzuar nga Prokuroria e Shteti për veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve te përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 paragrafi 2 i KPRK-se, sipas Aktakuzave PP/II.nr. 2170-1/17 e datës: 04.04.2018, PP/II.nr.1919-1/17 e datës: 04.04.2018, PP/II.nr.1776-1/17 e datës: 04.04.2018, PP/II.nr.1935-1/2017 e datës: 14.11.2017, PP/II.nr.1937-/17 e datës: 03.11.2017, PP/II.nr.301-3/18 e datës 30.01.2018, PP/II.nr.1491-3/15 e datës: 29.12.2017, PP/II.nr.1492-4/15 e datës 22.09.2016, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 06.08.2018 dhe 25.09.2018 në praninë e Prokurores së Shtetit Mimoza Syla si dhe të akuzuarve [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] si dhe te dëmtuarës-dëshmitares [REDACTED] mori dhe me 27.09.2018 publikisht shpalli kurse me date 24.10.2018 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari: [REDACTED] nga komuna Ferizaj, rruga [REDACTED] i lindur me: [REDACTED] ne [REDACTED] te Zvicrës, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë

██████████, ██████████, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike,

2. I akuzuari: ██████████ i lindur me datë: ██████████ nga i ati ██████████ dhe e ëma ██████████ e gjinisë ██████████ me vendbanim në rr. "██████████", Ferizaj, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i papunësuar, i gjendjes së dobët ekonomike.
3. I akuzuari: ██████████ i lindur me dt. ██████████, në Ferizaj, ku edhe tani jeton në rr. "██████████", nga i ati ██████████ dhe e ëma ██████████ e gjinisë ██████████ shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion frizer, i martuar, baba i tre fëmijëve, me gjendje të mesme ekonomike.

### ËSHTË FAJTOR

I akuzuari ██████████

#### SEPSE:

Me datë 22.08.2017, rreth orës 07:10, në rrugën "12 Qershori" në Ferizaj në kafiterinë "Tuneli", prone e të dëmtuarit : ██████████, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme dhe që vetit t'i sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme me përdorimin e forcës me një mjet të fortë (kaçavide) ka hapur derën e lokalit duke depërtuar brenda dhe aty ka marrë 10 (dhjetë) pije -Redbull, një (1) telefon të tipit "Iphone 4"si dhe pije të tjera me çka të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm në vlerë rreth 110€,

me të cilën në vazhdimësi ka kryer veprën penale Vjedhja e Rende nga neni 327 par.1 i KPRK-se.

Me datë:28.08.2017, rreth orës 03:30, në rrugën " Dëshmoret e Kombit", Ferizaj, konkretisht në lokalitetin "Ria Capital", prone e të dëmtuarit ██████████ i pandehuri me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme dhe që vetit t'i sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme me përdorimin e forcës me një mjet të fortë (kaçavidë) ka hapur

derën e lokalit duke depërtuar brenda dhe nga aty ka marre para ne vlere rreth 100€ si dhe një telefon "Iphone 4s",

**me te cilën ne vazhdimësi ka kryer veprën penale Vjedhja e Rende nga neni 327 par.1 i KPRK-se.**

Me date:03.04.2017, rreth orës 01:00, ne rrugën "Dëshmoret e Kombit", ne kafiterine "Chekin Bar", i pandehuri me te miturin [REDAKTUAR] me qellim te përvetësimit te sendeve te huaja te luajtshme dhe qe vetit t'i sjelle dobi pasurore ne mënyrë te kundërligjshme, ka hyre brenda lokalit dhe nga aty ka marre një instrument muzikore Kitare, ngjyre bardh e zi ne vlere rreth 250€, nje lloptop ngjyre hiri ne vlere prej 150 euro, HD Driver ne vlere prej 100 euro, pije alkoolike ne vlere prej 50 euro, dhe 40 euro para, me c'rast te dëmtuarit i ka shkaktuar dem material,

**Me te cilën ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 par. 1 i KPRK-se.**

Me date:21.06.2017, rreth orës 14:30, ne rrugën " Ramadan Rexhepi", Ferizaj, konkretisht ne Qendrën e Mjekësisë Familjare, i pandehuri me qellim te përvetësimit te sendeve te huaja te luajtshme dhe qe vetes t'i sjell përfitim te paligjshëm pasuror ne mënyrë te kundërligjshme ka marre pasurin e te dëmtuarës [REDAKTUAR] ashtu qe pasi ka hyre ne zyrën e te dëmtuarës ka marre çantën e krahut, ku brenda kishte portofolin, dy letërnjoftime, një karte te NLB, një karte te TEB dhe para ne vlerë prej 50 euro. Policia ia kishte kthyer te dëmtuarës çantën me dokumente, ndërsa paratë nuk i kishin kthyer, me çka te dëmtuarës i ka shkaktuar dem material ne vlere prej 50 euro,

**me te cilën ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 i KPRK-se.**

Me date:02.04.2015, rreth orës 01:30, ne rr."Tirana" ne Ferizaj, me qellim qe vetes t'i sjelle përfitim pasuror te kundërligjshëm ka depërtuar ne oborrin e te dëmtuari [REDAKTUAR] dhe ne një shupe afër derës kishte marre nje motor sharre te markës Shtill ne vlere prej 300 euro nga ku është larguar pa e vërejtur askush,

**Me te cilën ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 i KPRK-se.**

Me date 21 korrik 2017, rreth orës 04:00 ne rrugën "12 Qershori" ne Ferizaj me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm te dobisë pasurore me përdorimin e forcës me ane te nje mjete te forte ka shqyer mbulesën e lokalit-kafiterise" Konto" prone e te dëmtuarit [REDACTED] dhe me te depërtuar brenda merr një laptop te tipit "Lenovo" ngjyre e zeze, pesëmbëdhjetë (15) cope pije Redbull, pesëmbëdhjetë (15) te holla te metalit, NesCafe dhe një pale syze te firmës "Lacoste", ne vlere te përgjithshme prej shtatëqindë e gjashtëdhjetë (760) euro.

Prokuroria Themelore ne Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2170-1/17 ka akuzuar [REDACTED]

[REDACTED] dhe [REDACTED]

**SEPSE:**

Me date 28.08.2017, rreth orës 08:10, ne rrugën '12 Qershori" ne Ferizaj ne lokalit "Pure" prone e te dëmtuarës [REDACTED], te pandehurit pas nje marrëveshje paraprake e ne bashkëkryerje me qellim te përvetësimit te sendeve te huaja te luajtshme dhe qe vetes t'i sjellin dobi pasurore ne mënyrë te kundërligjshme me përdorimin e e forces me një mjet te forte kaçavidë kane hapur derën e lokalit duke depërtuar brenda dhe nga aty kane marre nje laptop te llojit "Samsung" ngjyre e zeze me adapter ne vlere rreth 300 euro, si dhe para te gatshme me çka te dëmtuarës i kane shkaktuar dem material ne vlere 335 euro,

**me te cilën ne bashkëkryerje kane kryer veprën penale Vjedhja e Rende nga neni 327 para.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se.**

Prokuroria Themelore ne Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1491-3/15 ka akuzuar [REDACTED]

[REDACTED] dhe [REDACTED]

**SEPSE:**

**I akuzuari [REDACTED]**

Me date 02.03.2015, rreth orës 02:00 ne rr. "Rexhep Bislimi" ne Ferizaj ne shtëpinë e te dëmtuarit [REDACTED] me qellim te përvetësimit te sendeve te huaja te luajtshme dhe qe vetes t'i sjell përfitim pasuror te paligjshëm, i pandehuri se bashku me te miturin [REDACTED] kane kaluar mbi murin e rrethojës se oborrit dhe kane hyre ne punëtori dhe nga aty kane vjedhur një

shpuese elektrike(burmashin), një brusalice dhe një gërryese elektrike, vlera e te cilave përfaqësisht është 100 euro,

Me te cilën ka kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 nën par. 1.1 të KPRK-se.

I akuzuari [REDAKTUAR]

Me date:07.04.2015 në Ferizaj nga i pandehuri në lokalin e tij ka blerë një shpuese elektrike(burmashin), një brusalice dhe një gërryese elektrike nga [REDAKTUAR] të gjitha në vlerë prej 12 euro, edhe pse ka mundur ta dije se të njëjtat janë përfituar me kryerjen e veprës penale të vjedhjes,

me te cilën ka kryer veprën penale Blerja, pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me vepër penale nga neni 345 paragrafi 2 i KPRK-se.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4,7,17,23,41,42,46,49,50,51,52,73 dhe 74 të KPK-se, si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së,

## G J Y K O N

I. TE AKUZUARIT [REDAKTUAR] ME DËNIM BURGIMI NE KOHËZGJATJE PREJ 18 (TETEMBEDHJETE) MUAJ,

Si dhe me DËNIM ME GJOBE NE SHUMEN PREJ 800(TETËQINDË) EURO, i cili është i obliguar që të paguaj në afatin prej tridhjetë ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit.

II. Nëse dënimi me gjobe nuk mund të ekzekutohet në ndonjërin nga mënyrat e përcaktuara me nenin 46 të KPRK-se, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burg do të jete ekuivalente me 20 euro dënim me gjobe që nuk është paguar ( Neni 46 par 3 i KPRK-se.)

- III. Te akuzuarit [REDAKTUAR] gjykata i shqipton dënim me kusht- 2 (dy) muaj burgim, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuar nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës kohore prej një (1) viti (koha e verifikimit).
- IV. Te dëmtuarit: [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ne pajtim me dispozitat nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së. per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.
- V. Konform dispozitave te nenit nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së. Obligohen te akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] qe secili vec e vec te paguajnë paushallin gjyqësor ne shumen prej 30/tridhjete/ euro në afatin prej pesembedhjete (15) ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcenim te përmbarimit te dhunshëm.
- VI. Obligohen te akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] qe secili vec e vec te paguajnë shumen prej 30/tridhjete/ eurove ne Fondin per Kompensimin e Viktimave te Krimet brenda afatit prej pesembedhjete (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së

## II

### LIROHET NGA AKUZA

I akuzuari [REDAKTUAR]

#### SEPSE:

Me date 28.08.2017, rreth orës 08:10, ne rrugën '12 Qershori' ne Ferizaj ne lokali "Pure" prone e te dëmtuarës [REDAKTUAR], te pandehurit pas nje marrëveshje paraprake e ne bashkëkryerje me qellim te përvetësimit te sendeve te huaja te luajtshtëm dhe qe vetes t'i sjellin dobi pasurore ne mënyrë te kundërligjshme me përdorimin e forcës me nje mjet te forte kacavide kane hapur derën e lokalit duke depërtuar brenda dhe nga aty kane marre nje laptop te llojit "Samsung" ngjyre e zeze me adapter ne vlere rreth 300 euro, si dhe para te gatshme me cka te dëmtuarës i kane shkaktuar dem material ne vlere 335 euro,

**Meqë nuk është provuar se i akuzuari ne bashkëkryerje ka kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 nënë par 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

### **A r s y e t i m i**

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate dhe veprat penale për te cilat akuzohen të pandehurit gjykohen nga gjyqtarja e vetme gjykuese.

PTH ne Ferizaj me aktakuzat PP/II.nr. 2170-1/17 e datës: 04.04.2018 , PP/II.nr.1919-1/17 e datës: 04.04.2018, PP/II.nr.1776-1/17 e datës: 04.04.2018, PP/II.nr.1935-1/2017 e datës: 14.11.2017, PP/II.nr.1937-1/17 e datës: 03.11.2017, PP/II.nr.301-3/18 e datës 30.01.2018, PP/II.nr.1491-3/15 e datës: 29.12.2017, PP/II.nr.1492-4/15 e datës 22.09.2016 ka akuzuar [REDAKTUAR] për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Vjedhje e rende nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-së, dhe [REDAKTUAR] per shkak se ne bashkëkryerje me te akuzuarin e pare [REDAKTUAR] kane kryer veprën penale Vjedhje e rende nga neni 327 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, ndërsa [REDAKTUAR] është akuzuar nga Prokuroria e Shtetit per veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve te përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 paragrafi 2 i KPRK-se.

Gjykata duke vepruar ne pajtim me nenin 245 te KPRK-se ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 06.08.2018, dhe shqyrtimin gjyqësore me date 25.09.2018, ne te cilin shqyrtim gjykata pasi ka vërejtur se shumica e veprave penale janë kryer nga i njëjti person, disa prej te cilave i ka kryer ne bashkëkryerje edhe me te akuzuarit tjerë si dhe pasi ka vërejtur se veprat penale kane lidhshmëri me njëra-tjetrën, ne kuptim te nenit 35.par.1 i KPRK-se vendosi për bashkimin e procedurës për veprat penale si dhe për akuzat e lartë cekura. Gjykata sipas detyrës zyrtare konstatoi se po ashtu janë plotësuar kushtet ne kuptim te nenit 81 te KPRK-se pika 1.1, 1.4 dhe 1.5, prandaj gjykata beri rikualifikimin e veprave penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 nenpar.1.1 te KPRK-se ne veprën penale ne vazhdim vjedhje e rende.

Ndërsa sa i përket te akuzuarit [REDACTED] gjykata ka veçuar procedurën me aktvendim te veçantë pasi qe i njëjti ne baze te memorandumit zyrtar nga policia me numër Ref. 04/1-05F-759/18 te datës 06.08.18 dhe pas verifikimit gjykata është njoftuar se [REDACTED] ne baze te deklarimit te prindit te tij gjendet jashtë shtetit te Kosoves përkatësisht ne Gjermani.

Ne hapjen e shqyrtimit gjyqësor, gjyqtarja konstatoi se janë plotësuar te gjitha kushtet per te mbajtur shqyrtimin gjyqësor ne kuptim te nenit 305 te KPPRK-se, me pastaj gjyqtarja i udhëzoi te akuzuarit ne kuptim te nenit 246 par.1 i KPPK-se, dhe çmoi se te drejtat e te akuzuarve janë respektuar. Me pas Prokurorja u ka lexuar te akuzuarve aktakuzat dhe pasi qe gjykata është bindur se te njëjtit e kane kuptuar ne tërësi aktakuzën me te cilën janë akuzuar, te akuzuarve u ka ofruar te drejtën te deklarohen lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tyre për veprat penale për te cilat akuzohen.

Prokurorja ne fjalën përfundimtare ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED], pasi qe te akuzuarit e kane kuptuar natyrën dhe rëndësinë e pranimit te fajësisë, se pranimi është bere vullnetarisht dhe se ai mbështet ne provat dhe faktet qe gjenden ne shkresat e lendes. Po ashtu Prokurorja me këtë rast theksoi se mbetet pranë aktakuzës me nr. 2170-1/17 kundër te akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED] pasi qe ne baze te provave, dëshmisë se te akuzuarit [REDACTED] dhe dëgjimit te dëshmitares vërtetohet se te akuzuarit ne bashkëkryerje e kane kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 327 par.1 nenpar.1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, andaj kërkoi nga gjykata qe te njëjtit t'i shpall fajtor dhe te ju shqiptoje sanksion penal ne pajtim me ligjin.

Me që te akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] e kane pranuar fajësinë gjyqtarja vetme gjykuese ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 lidhur me nenin 326 të KPPK-së:

-te akuzuarit e kane kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,

-pranimi është bërë vullnetarisht nga te akuzuarit,

-pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit siç janë: Procesverbalet për marrjen ne pyetje te te dyshuarve dhe te dëmtuarve(dëshmitareve) nga ana e policisë me nr:2015-CF-732 i datës



07.04.2015, nr.2017-CF-1288 i datës 07.09.2018, nr.2017-CF-1830 i datës 07.09.2018, nr.2017-CF-1891 i datës 07.09.2018, nr.2017-CF-682 i datës 04.04.2017, nr.2017-CF-1526 i datës 26.07.2017, nr.2017-CF-1890 i datës 12.10.2017 dhe procesverbali nr.2015-CF-0708, ne Kallëzimit Penale te Policisë, ne Raportet e policisë te përpiluara ne vendngjarje si dhe te gjitha fotografitë dhe shkresat e tjera te bashkangjitura ne shkresat e lendes si dhe dëshmitë e te akuzuarve dhe te dëmtuarve.

Me qenë se të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] e kane pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja konform nenit 248 paragrafit 4 lidhur me nenin 326 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

I akuzuari [REDAKTUAR] ne shqyrtimin fillestar e po ashtu edhe ne fjalën përfundimtare ka theksuar se e pranon fajësinë për veprat penale për te cilat është akuzuar dhe se bashku me [REDAKTUAR] laptopin e vjedhur ia kanë shitur një shoku te [REDAKTUAR] dhe se me ne pjese te atyre parave kane blere substanca narkotike. ndërsa pjesën tjetër e kane ndare se bashku, po ashtu potencojë faktin se me me te akuzuarin [REDAKTUAR] kane qene shok, është penduar thelle për veprat penale te kryera, se veprat penale i ka kryer me arsyetimin se babain e ka te sëmurë dhe ka qene i shtyre nga shkak i mungesës se parave, se është përdorues i rregullt i substancave narkotike dhe se për shkak te ndikimit te tyre nuk mund te kontrolloje veten, andaj duke i marre parasysh këto rrethana ka kërkuar nga gjykata qe t'i shqiptojë një dënim sa me te bute.

I akuzuari [REDAKTUAR] ne shqyrtimin e datës 06.08.2018 nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për te cilën është akuzuar nga ana e prokurorisë, ndërkaq ne shqyrtimin e datës 25.09.2018 i akuzuari pasi është udhëzuar nga gjykata ne kuptim te nenit 246 par.1 i është dhënë mundësia qe serish te deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për te cilën akuzohet me c'rast ai ka theksuar se e pranon fajësinë për veprën penale pranimi, blerja ose fshehja e mallrave te përfituara me kryerjen e veprave penale nga neni 345 par.2 i KPRK-se. Po ashtu i akuzuari ne ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se shpreh keqardhje dhe është penduar thelle për veprën e kryer, është hera e pare qe ndeshet me ligjin dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do te përsërisë vepra te tilla penale ne te ardhmen.

I akuzuari [REDAKTUAR] ne fjalën përfundimtare ka theksuar se nuk e ndien veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet nga ana e prokurorisë duke theksuar se nuk e ka kryer këtë veprë

**Mbrojtja e të akuzuarit :** [REDAKTUAR] nëm mbrojtjen e tij e po ashtu edhe në fjalën përfundimtare nuk e ka pranuar kryerjen e veprës penale, sipas aktakuzës në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me të akuzuarin [REDAKTUAR] është e vërtet se ndihemi dhe zakonisht me të njëjtin ka konsumuar substanca narkotike dhe parat të cilat i kishte siguruar i kishte marrë prej motrave të tij, duke shtuar se me [REDAKTUAR] kishte raporte shoqërore dhe atë: duke konsumuar (bari hashish) të cilën e kishin konsumuar së bashku, ndërsa sa i përket kryerjes së veprës penale me të akuzuarin [REDAKTUAR] deklaron se nuk është e vërtet dhe nuk ka qenë së bashku me [REDAKTUAR] duke kërkuar drejtësi nga ana e Gjykatës, në lidhje me këtë rast.

Gjykata ka bërë prezantimin e provave – ka dëgjuar të dëmtuarën [REDAKTUAR]

Nga dëshmia - të dëmtuarës- dëshmitares [REDAKTUAR], pasi është paralajmëruar nga gjykata ne kuptim të dispozitave të nenit 125 par.1 dhe nenit 129 të KPPK-se si dhe neneve 390,391 të Kodit Penal, ne dëshminë e saj ka theksuar se është me profesion frizere dhe se është pronare e lokalit "[REDAKTUAR]" që gjendet në rrugën "12 Qershori" dhe se ditën kritike nuk ka qenë në lokal, por aty ka qenë një punëtoare e saj, e cila pasi e ka vërejtur se dera e lokalit që ka qenë e hapur (edhe pse ajo ka qenë e mbyllur me çelës) menjëherë e ka lajmëruar dëshmitaren (pronaren e lokalit), dhe me pastaj punëtoarja e ka lajmëruar policinë të cilët kanë ardhur në vendin e ngjarjes. Me tutje dëshmitarja shton se pasi ka ardhur te lokali ka vërejtë se i mungojnë laptopi i firmës "Samsung" dhe një shumë e të hollave prej 35€ e cila ka qenë shuma e fituar gjatë ditës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit [REDAKTUAR] ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhja e Rende nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se.

Po ashtu gjykata konstatoi se vlerësuar nga aspekti juridik në veprimet e të akuzuarit [REDAKTUAR] ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 i KPRK-se.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për te akuzuarin [REDAKTUAR] gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73, 74 dhe 75 të KPRK-së. Gjykata ka bërë zbutjen e dënimit nga minimumi i dënimit nga 3/tri/ vite në 18 muaj burgim konform dispozitave të lartë cekura dhe gjeti si rrethana veçanërisht lehtësuese se i akuzuari në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprat penale të kryera, gjendjen e dobët ekonomike, si rrethana renduese gjykata gjeti se i akuzuari është recidivist ( përsëritës) i veprave penale pasi që me pare ka qene i dënuar me Aktgjykime të plotfuqishme P.nr.2669/17<sup>1</sup> dhe P.nr.2403/17.<sup>2</sup>

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për te akuzuarin [REDAKTUAR] gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohet , duke shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer ,është hera e pare që ndeshet me ligjin dhe i ka premtuar gjykatës se në te ardhmen do te jete me i kujdesshëm dhe se nuk do te kryeje vepra te tjera penale. Për sa i përket rrethanave renduese gjykata pas verifikimeve te nevojshme erdhi në përfundim se nuk ekziston ndonjë rrethane renduese veçse e vlerësoi shkallen përgjegjësisë penale te te akuzuarit.

Andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarve u shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarve.

**Sa i përket pjesës së II (dyte)** se këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës Liruese, Gjykata në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPRK- te akuzuarin [REDAKTUAR] e liron nga akuza se në bashkëkryerje me te akuzuarin [REDAKTUAR] ka kryer veprën penale Vjedhje e Rende nga neni 327 par 1 pika 1.1 lidhur me nenin 32 te KPRK-se, ngase nuk është vërtetuar se e ka kryer veprën penale për te cilën është akuzuar nga Prokuroria Themelore me aktakuzën PP/II.nr.2170-1/17.

<sup>1</sup> Aktgjykimi P.nr.2669/17 është bërë i plotfuqishëm me date: 11.06.2018, ndërsa i ekzekutueshëm me date: 12.06.2018.

<sup>2</sup> Aktgjykimi P.nr.2403/17 është bërë i plotfuqishëm me date: 30.05.2018, ndërsa i ekzekutueshëm me date: 12.06.2018.

Pretendimin e te akuzuarit [REDAKTUAR] se ne bashkëkryerje me te akuzuarin [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] kane kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 327 par 1 pika 1.1 lidhur me nenin 32 te KPRK-se dhe se me te njëjtin ka raporte shoqërorë, gjykata e konsideroi si jo real dhe si prove objektive dhe jo prove qe lidhet me elementin subjektiv te bashkëkryerjes se kësaj vepre penale ngase ai nuk mbështetej dhe nuk mund te vërtetohej me asnjë prove konkrete.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të të akuzuarve, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin "in dubio pro reo"*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të akuzuarve dhe të drejtave të tyre sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë "*in peius*" ndaj të akuzuarve duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kushte për argumentet që janë "*in favorem*" ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Andaj ne mungese te provave gjykata e liroi nga akuza [REDAKTUAR] ashtu siç është theksuar edhe ne dispozitivin II te këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal,**

**P.nr.872/16 datë 25.09.2018**

Procesmbajtëse,

Marigona Shaqiri

Gjyqtarja,

Hakile Ilazi



**KËSHILLE JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit me shkrim të kopjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes Gjykatës Themelore në Ferizaj.